

Raport për rezultatet e konsultimeve publike për:

“Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të Planit të Veprimit 2024–2026”

1. Titulli i projektaktit

“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të Planit të Veprimit 2024–2026”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Takimi i parë i Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) u mbajt në datë 21 qershor 2023, në ambientet e Hotel Tirana Internacional. Në këtë takim morën pjesë anëtarët e Grupit Drejtues për Migracionin (ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 35, datë 10.3.2021), u ftuan dhe morën pjesë përfaqësues nga institucionet e tjera të që trajtojnë çështje të migracionit si dhe organizatat ndërkombëtare. Takimi pati në fokus të diskutimit problematikat e dala gjatë zbatimit të strategjisë dhe rekomandimet e Raportit përfundimtar të Progresit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2019-2022. Në takim u miratuan qëllimet politike dhe objektivat strategjike.

Me qëllim vijimin e punës në përputhje me prioritetet e përcaktuara, Ministria e Brendshme me mbështetjen e IOM kanë organizuar disa ëorkshop-e kombëtare, në datat 9, 10 dhe 19 maj 2023. Ëorkshop-et informuese të datave 9 dhe 10 maj kanë qenë të lidhura me zbatimin e Paktit Global për Migracionin (GCM) dhe identifikimin e objektivave prioritarë të tij që do të përfshiheshin në dokumentin strategjik.

Më 9 Maj 2023 u zhvillua një workshop me përfaqësuesit e institucioneve kryesore të Qeverisë së Shqipërisë dhe më 10 Maj 2023 një workshop me partnerët dhe grupet e interesit, ku morën pjesë përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri, shoqëria civile, sektori publik, academia etj.

Në datën 19 maj 2023, Ministria e Brendshme organizoi, me mbështetjen e IOM-it, një tjetër workshop “Për vlerësimin e situatës aktuale dhe prioritetëve kryesore në fushën e migracionit në Shqipëri, në funksion të hartimit të draftit të ri. Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit”. Në këtë takim punë morën pjesë përfaqësues të grupit ndërinstitucional për hartimin e Strategjisë, përfaqësues nga MB dhe institucionet kryesore përgjegjëse për migracionin, si dhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë nga IOM. Gjatë takimit u prezantua një kornizë/strukturë fillestare e Strategjisë së ardhshme nga Sekretariati Teknik për Migrim në MB dhe ekspertë mbështetës të IOM-it.

Në datat 20-21 Shtator 2023, u zhvillua në Pogradec një workshop mbi hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2024-2030, ku ishin të ftuar,

anëtarët e GNP-së, si dhe përfaqësues të të gjithë institucioneve të parashikuara si zbatuese kryesore dhe bashkëzbatuese të ndërhyrjeve konkrete. Workshop-i u moderua dhe monitorua nga Sekretariati Teknik për Migracionin në MB dhe ekspertët e IOM.

Gjithashtu, projektligji u publikua në RENJK për periudhën 6 nëntor 2023 deri në 6 dhjetor 2023, në respektim të afateve ligjore.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të Planit të Veprimit 2024–2026 janë tre:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK.
2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr.33 datë 13.3.2023 “Për ngritjen e grupit të punës në Ministrinë e Brendshme për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe planit të saj të veprimit”.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike).

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese. Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin,
- Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin,
- Ekspertët e IOM,
- Agjencitë e BE, (EUAA, DGHOME, DGNEAR, DBE)
- UNHCR

- Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)
- Koordinatorin për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

<i>Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	<i>Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	<i>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	<i>Vendimi (I pranuar/ I pranuar pjesërisht/ I refuzuar)</i>	<i>Justifikimi</i>
Përafrimi i mëtejshëm i Strategjisë me dokumentet e politikave strategjike dhe operacionale të BE-së, veçanërisht me Planin e Veprimit të BE-së.	Strategjia duhet të ketë një fokus më të fortë dhe të përafrohet më mirë me dokumentet e politikave strategjike dhe operacionale të BE-së, veçanërisht me Planin e Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor të paraqitur në dhjetor 2022. Shqipëria është angazhuar për zbatimin e saj në disa raste që nga prezantimi i saj, e fundit është në Forumin Ministror të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme BE-	Agjencitë e BE, (EUAA, DGHOM E, DGNEA R, DBE)	I pranuar	Nisur nga politikat e përcaktuara në SKZHIE, Strategjia Kombëtare e Migracionit është një dokument i cili orientohet nga vizioni për migracionin që: “Deri në vitin 2030, në frymën e proceseve globale të migracionit dhe integritetit të Shqipërisë në BE, të jepet një

	Ballkani Perëndimor i mbajtur në Shkup më 26 tetor 2023. Prandaj, fokusi në pesë shtyllat prioritare për menaxhimin efektiv të migracionit të përcaktuara në këtë Plan Veprimi duhet të pasqyrohet plotësisht në Strategji, në mënyrë që të përfaqësojë prioritetet shqiptare me atë të BE-së: menaxhimi i kufijve, azili dhe pritja, kthimi dhe ripranimi, lufta kundër kontrabandës së emigrantëve, harmonizimi i politikave të vizave.			përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit, në kuadrin e Shqipërisë. Qeverisja efektive e migracionit në Shqipëri, nëpërmjet trajtimit dhe menaxhimit të problemeve dhe sfidave që dalin nga lëvizjet e migrantëve, me synim rritjen e ndikimit të migracionit në zhvillimin e vendit, në dobi të emigrantëve dhe shoqërisë shqiptare”.
Identifikimi dhe referimi i plotë në Strategji, i rasteve kur janë trajtuar 5 çështjet e adresuara (menaxhimi i kufijve, azili dhe pritja, kthimi dhe ripranimi, lufta kundër kontrabandës së emigrantëve, harmonizimi i politikave të vizave,) në strategjitë tjera.	Aty ku një ose më shumë nga prioritetet e mësipërme janë trajtuar tashmë në dokumente të tjera strategjike kombëtare, Strategjia e Migracionit 2024-2030 duhet të ofrojë një referencë të qartë për to dhe të shpjegojë se si do të ndërveprojnë me orientimet e politikave të paraqitura në Strategji. Kjo mund të konsiderohet, për shembull, në rastin e	Agjencitë e BE, (EUAA, DGHOM E, DGNEA, DBE.)	I refuzuar	Është parashtruar fakti që në seksionin Kuadri Strategjik Kombëtar, janë parashikuar të gjitha dokumentat strategjike të miratuara nga qeveria shqiptare, të cilat trajtojnë çështjet migratore, duke parashikuar edhe mënyrën e ndërveprimit

	Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027.			ndërmjet tyre për këto çështje.
Përfshirja në Strategji e rekomandimeve për menaxhimin e migracionit, dhe azilit sipas raporteve të BE.	Strategjia duhet të tregojë se si do të adresohen rekomandimet për menaxhimin e migracionit dhe azilit të përcaktuara në Raportin e Zgjerimit të BE-së 2023, në Raportin e Gjashtë të Mekanizmit të Pezullimit të Vizave dhe në Raportin e Shqyrtimit të Shqipërisë të korrikut 2023 gjatë gjithë kohëzgjatjes së Strategjisë. Referenca të mëtejshme mund të bëhen për planin e veprimit të rinovuar të BE-së kundër kontrabandës së emigrantëve (2021-2025). Konkluzionet e takimeve/deklaratave të përbashkëta politike të nivelit të lartë, të tilla si takimet ministrore të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme BE-Ballkani Perëndimor në Tiranë (2022) dhe Shkup (2023) si dhe Aleanca Globale Kundër Kontrabandës së Emigrantëve të 28	Agjencitë e BE, (EUAA, DGHOM E, DGNEA R, DBE.)	I refuzuar	Shqipëria ka përafruar pjesërisht legjislacionin me EU Acquis për politikën e vizave. MEPJ, përgjegjës për hartimin e politikës së vizave dhe garantimin e përputhshmërisë me BE, ka ndërmarrë hapa konkretë për njësimin e plotë të politikës së vizave me BE. Kjo përfshin heqjen e regjimit pa viza për shtete që paraqesin rrezik, si Bjellorusia. Shqipëria ka implementuar sistemin digjital të e-vizave sipas rekomandimeve të BE dhe po punon për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit dhe politikave të vizave. Politikat e parandalimit të

	nëntorit 2023 duhet të identifikohen dhe të integrohen në vizionin strategjik.			trafikimit të migrantëve janë përfshirë në Strategjinë kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, me masa konkrete të parashikuara.
Forcimi dhe përfshirja e referencave për bashkëpunimin dhe mbështetjen operative të agjencive të BE.	Referencat për bashkëpunimin dhe mbështetjen operative të agjencive të BE-së mund të forcohen. Në veçanti, mungojnë referencat për bashkëpunimin me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Azilin dhe bashkëpunimin nën udhërrëfyesin e bashkëpunimit Shqipëri-EUAA dhe aspekte të ndryshme të bashkëpunimit me Frontex mund të përditësohen (përfshirë Marrëveshjen e përditësuar të Statusit dhe si do të ndërveprojnë dislokimet e ardhshme të ekipeve të përbashkëta me Strategjinë, operacionet e përbashkëta, Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar në qershor 2023, etj).	Agjencitë e BE, (EUAA, DGHOM E, DGNEA R, DBE)	I pranuar	Është pranuar sugjerimi dhe është përfshirë në Strategji një seksion i posaçëm që thekson bashkëpunimet dhe operacionet e përbashkëta me agjencitë e BE-së, si patrullimi i përbashkët i kufijve tokësorë dhe detarë me Frontex, bashkëpunimi me IOM për menaxhimin e flukseve migratore, dhe rritja e kapaciteteve të strukturave të Drejtorisë për Kufirin dhe Migracionin.

Përmbledhje e kuadrit ligjor dhe institucional, dokumenteve strategjike, për të evidentuar më qartë problematikat, sfidat dhe metodologjitë në përmirsim të legjislationit rrespektiv.	Pjesa që i kushtohet përshkrimit të kuadrit ligjor dhe institucional, dokumenteve strategjike dhe ligjeve ekzistuese, si dhe aktiviteteve operative të kaluara në lidhje me migracionin dhe azilin mund të shkurtohet në favor të një analize dhe shtjellimi më të thellë të kontekstit dhe arsyesimit për veprim, d.m.th. të specifikave të situatës migratore në Shqipëri dhe sfidave në trajtimin e migracionit të përzier. Kjo më pas mund të çojë në një përshkrim se si do të adresohen këto sfida.	Agjencitë e BE, (EUAA, DGHOM E, DGNEA R, DBE)	I pranuar	Seksioni është ripunuar dhe sugjerimi është reflektuar.
Përfshirja në Strategji të një qëllimi politikash dhe një objektivi më specifik që fokusohet në mbrojtjen ndërkombëtare, adresim më adekuat të çështjeve që prekin azilin dhe refugjatët.	Përfshirja dhe bashkërendimi i aktorëve publik, dhe instucioneve, organizatave ndërkombëtare, përgjegjës për çështjet e azilit, refugjatëve dhe mbrojtjes ndërkombëtare, forcimi i mjeteve të trajtimit të rasteve, procesimi i ankesave si dhe përforcimi nëpërmjet përfshirjes së EUAA në trajtimin e rasteve dhe forcimin e kapaciteteve.	Agjencitë e BE, (EUAA, DGHOM E, DGNEA R, DBE.)	I pranuar	Komenti është pranuar dhe reflektuar në Strategji.
Rritja e rasteve të migrimin të parregullt drejt	Mospërputhja e politikës së vizave në Ballkanin Perëndimor	Agjencitë e BE, (EUAA,	I pranuar	Komenti është pranuar dhe

vëndeve të BE-së, për shkak të problematikave dhe mungeses së përputhshmërisë së politikës së vizave të Ballkanit Perëndimor me Kodin e Vizave të BE.	me atë të BE-së krijoi një rritje të ardhjeve të parregullta në BE përmes rrugës së Ballkanit Perëndimor në vitin 2022. Nevoja për të trajtuar këtë çështje është theksuar në disa dokumente të politikave të BE-së, si dhe në nivel të lartë apo takime ministrore. Strategjia duhet të përfshijë një vizion se si autoritetet shqiptare synojnë të trajtojnë mungesën e harmonizimit të politikës së vizave me BE-në, veçanërisht nga pikëpamja e menaxhimit të migracionit.	DGHOM E, DGNEAR, DBE.)		reflektuar në Strategji.
Krijimi i një platforme të sofistikuar digjitale, në përputhje me standardet dhe rekomandimet e BE-së, për menaxhimin e flukseve migratore dhe regjistrimin e refugjatëve dhe azilkërkesve që vijnë në kufi, në bashkëpunim me strukturat ligjzbatuese të BE-së si Frontex etj.	Një aspekt i rëndësishëm për të siguruar një menaxhim efektiv të migracionit është aftësia për të identifikuar dhe regjistruar migrantët dhe aplikantët për azil në kufi. Strategjia mund të përfshijë një referencë për një masterplan për krijimin e një sistemi IT në përputhje me BE-në për identifikimin dhe regjistrimin e flukseve të përziera të migracionit që do të zhvillohet nga Frontex në bashkëpunim të	Agjencitë e BE, (EUAA, DGHOM E, DGNEAR, DBE)	I pranuar	Komenti është pranuar dhe reflektuar në Strategji.

	ngushtë me autoritetet shqiptare, për të cilin autoritetet shqiptare kanë rënë dakord. Një masterplan i tillë do të përfshijë një analizë të detajuar të sistemit kombëtar të regjistrimit, mangësive dhe sfidave të tij, dhe një përpunim të një udhërrëfyese të përshtatur për vendosjen e zgjidhjeve teknike, operacionale dhe administrative për ta bërë sistemin shqiptar në përputhje me BE-në.			
Shtjellimi dhe përdorimi më konciz në Strategji të referencave nga MGR, Marrëveshjes Globale për Refugjatët veçanërisht paragrafit 12 të saj që trajton lëvizjet e përziera dhe zgjerimin e fushës së Strategjisë duke ndarë kategoritë e refugjatëve dhe azilkërkuesve.	Përfshirjen e një reference të qartë për MGR, veçanërisht paragrafit 12 të saj që trajton lëvizjet e përziera; zgjerimin e fushës së Strategjisë, duke bërë një dallim të qartë midis kategorive të ndryshme të personave ndaj të cilëve do të zbatohet Strategjia, në mënyrë që të shmanget konfuzioni midis të drejtave të migrantëve dhe të drejtave të refugjatëve, duke përfshirë ata të cilëve u është dhënë një formë plotësuese mbrojtjeje ose statusi i mbrojtjes së përkohshme në Shqipëri; zëvendësimin	UNHCR	I pranuar	Kompakti Global për Refugjatët është reflektuar në Strategji, si dhe është bërë një përkthim i detajuar për efektet e tij.

	e terminologjisë “migrantë të parregullt” me “refugjatë, azilkërkues dhe migrantë”; garantimin që ky dallim të bëhet i dukshëm dhe funksional, duke filluar nga aspektet procedurale, të drejtat mbi statusin, qasjen efektive në të drejta dhe shërbime etj.			
Zbatimi i plotë i Planit të Veprimit të Ballkanit Perëndimor, për garantimin e procedurave të shpejta për azilin dhe mbështetje.	Ashtu sikurse u theksua gjatë diskutimit të Tryezës së Rrumbullakët dhe në funksion të aspiratave në rritje të Shqipërisë për anëtarësim në BE, vlerëson të rëndësishme të rikujtohen prioritetet e përcaktuara në Planin e Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor, dhjetor 2022, (inter alia) synon të garantojë procedura të shpejta për azilin dhe mbështetje për kapacitetet pritëse.	UNHCR	I pranuar	Kompakti Global për Refugjatët është reflektuar në Strategji, si dhe është bërë një përshkrim i detajuar për efektet e tij.
Krijimi i zyrave të migracionit dhe diasporës, të krijuara në nivel të vetëqeverisjes lokale, për decentralizimin e proceseve në nivel qendror, duke	Sugjerohet përdorimi më i mirë i zyrave të migracionit dhe diasporës të parashikuara të krijohen në nivel të vetëqeverisjes lokale, si një rrugë e mundshme drejt	UNHCR	I refuzuar	Evidentoher se zyrat vendore për migracionin dhe diasporën, bazuar në ligjin për vetëqeverisjen vendore kanë kompetenca vetëm për

përfshirë procedurat e azilit.	decentralizimit të proceseve në nivel qendror, duke përfshirë procedurat e azilit. Për këtë sugjerim, UNHCR, është e gatshme ti prezantojë Ministrisë konceptin e saj, në mënyrë që Termat e Referencës të ardhshme për këto zyra të mund të zhvillohen në mënyrë gjithëpërfshirëse.			migracionin dhe diasporën.
Përfshirja më e plotë e shërbimeve të integruara për personat që i u është dhënë mbrojtja ndërkombëtare në Shqipëri, për të intensifikuar qasjen e tyre në shërbimet dhe programet e dedikuara.	Teksi përfundimtar i Strategjisë të ketë pika më konkretet në lidhje me perspektivat për integrimin lokal në Shqipëri, duke përfshirë, për shëmbull, përfshirjen e më shumë detajeve mbi hapat praktikë të nevojshëm për të adresuar në mënyrë efektive mangësitë me të cilat përballen personat të cilëve u është dhënë mbrojtja ndërkombëtare në Shqipëri, në mënyrë që të sigurohet se ata janë në gjendje të kenë qasje dhe të përfitojnë nga të drejtat dhe shërbimet e tyre në vend.	UNHCR	I pranuar	Komenti është pranuar dhe sugjerimi është refektuar në Qëllimin Politik 4 “Forcimi i sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare, garantimi i të drejtave të azilkërkuesëve dhe refugjatëve dhe ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme”.
Evidentimi i qartë i problematikave në legjislacionin e brëndshëm, përcaktimi i	Identifikimi i plotë i nevojave për ndryshime ligjore të legjislacionit kryesor dhe dytësor për	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)	Komenti 1, i pranuar pjesërisht.	Parashikohet rishikimi i legjislacionit bazë për të mundësuar

nevojave për ndryshimin e legjislacionit kryesor dhe dytësor për migracionin, si dhe intensifikimi i raportimit mbi zbatueshmërinë e legjislacionit dhe konventave për migracionin dhe zbatueshmërinë e tyre nga institucionet publike.	migracionin si dhe evidentimi i plotë zbatimit të konventave rrespektive. Masa prioritare 1.1.1 – Përmirësimi i kuadrit ligjor kombëtar me kuadrin ligjor të BE-së dhe ndërkombëtar për qeverisjen e migracionit. “Vlerësimi i statusit të ratifikimit, monitorimit dhe raportimit të nivelit të zbatimit të konventave të ratifikuara që kanë lidhje në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë me garantimin e të drejtave të migrantëve”,		Komenti 2, i pranuar	përmirësimin e zbatimit të ligjeve dhe shërbimeve për migrantët, si dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Sugjerimi për ratifikim u reflektua dhe drafti merr parasysh rekomandimet e KE për Shqipërinë. Gjithashtu, në draftin SKM dhe PV janë parashikuar ndërhyrje për forcimin e kapaciteteve dhe ngritjen e regjistrave për mbledhjen, përpunimin, shkëmbimin dhe raportimin e të dhënave.
Trajnimi i vazhdueshëm dhe efektiv i punonjësve të sporteleve të migracionit, informimi dhe përgatitja e tyre në konformitet me ndryshimet ligjore, duke rritur kapacitetet e këtyre zyrave.	Në lidhje me masën prioritare 1.1.2 - Rritja e kapaciteteve institucionale dhe rishikimi i strukturave në institucionet në nivel qendror dhe vendor për qeverisjen efektive të migracionit, të krijohet struktura e vecantë për trajnimin e punonjësve të këtyre sporteleve, informimi	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)	Komenti i refuzuar.	Evidentohe se draft-strategjia përmban një parashikim për ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit ndërinstitutional, për kthimin dhe riintegrimin, për përmirësimin e bashkërendimit të punës institucionale dhe

	dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit, rritja e kapaciteteve në nivel vendor për pritjen dhe informimin adekuat të azilkërkuesve.			informimit të qytetarëve si dhe Plani i Veprimit që parashikon hartimin e një manuali për ndihmën dhe riintegrimin e të kthyerve me në fokus kategoritë vulnerabël.
Përmirësimi i mekanizmave të koordinimit për qeverisjen e migracionit, duke përfshirë aktorë të shoqërisë civile në trajtimin e kategorive vulnerabël dhe të miturive në mënyrë adekuate.	Masa prioritare 1.1.3 - Përmirësimi i mekanizmave të koordinimit për qeverisje e migracionit. Përtej ndërhyrjeve të parashikuara, KShH vlerëson se nevojitet një koordinim dhe bashkëpunim më i madh midis institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e migracionit dhe atyre psikosociale apo të trafikimit. Gjithashtu nevojitet një hapësirë më e madhe veprimi edhe për aktorët joqeveritarë (sikurse janë OJF, aktivistët e të drejtave të njeriut, universitetet, etj). Duke qënë së është parashikuar rishikimi i përbërjes dhe përfaqësimit institucional të Komitetit Teknik të Migracionit, sugjerohet që të përfshihen përfaqësues të	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)	I refuzuar	Draft-strategjia synon përmirësim të mëtejshëm të mekanizmave koordinues, përfshirë miratimin e urdhrave për rishikimin e përbërjes dhe përfaqësimit institucional të Komitetit Teknik të Migracionit dhe GDM, me qëllim trajtimin e të gjitha çështjeve dhe politikave për menaxhimin e migracionit, duke përfshirë të gjithë aktorët relevantë, jo-qeveritar.

	strukturave të mësipërme, për të trajtuar më me efikasitet problematikat e adresuara. Kryesisht një sërë problematikash të evidentuara lidhen me trajtimin e të miturve, pasi ata nuk bëhen pjesë e sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe nuk përfitojnë trajtimet e posaçme sipas legjislacionit në fuqi.			
Përfshirje më e gjërë e OSHC-ve për zbatimin e masave 1.2 – Hartimi dhe rishikimi i politikave të migracionit bazuar në të dhëna të sakta dhe koordinuara. Masa 1.2.1 (Krijimi i një metodologjie të koordinuar për përmbledhjen e të dhënave), masa 1.2.2 (Shkëmbimi dhe ndërveprimi efektiv për të dhënat e migracionit) & masa 1.2.3 (Studimi dhe vlerësimi i të	Objektivi 1.2 – Hartimi dhe rishikimi i politikave të migracionit bazuar në të dhëna të sakta dhe koordinuara. Masa 1.2.1 (Krijimi i një metodologjie të koordinuar për përmbledhjen e të dhënave), masa 1.2.2 (Shkëmbimi dhe ndërveprimi efektiv për të dhënat e migracionit) & masa 1.2.3 (Studimi dhe vlerësimi i të dhënave të migracionit për të hartuar/dokumente). Masat prioritare e këtij objekti specifik përputhen me qëllimin strategjik, janë realiste dhe të monitorueshme. Rekomandohet një	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)	I refuzuar	Draft-strategjia në planin e saj të veprimit parashikon krijimin e një metodologjie për mbledhjen e të dhënave dhe përmirësimin e shkëmbimit dhe ndërveprimin efektiv me qëllim përdorimin e tyre për të hartuar politika për menaxhimin e migracionit, duke përfshirë të gjithë aktorët e shoqërisë civile.

dhënave të migracionit për të hartuar/dokument e).	përfshirje më e gjerë e OSHC-ve si për ofrimin e të dhënave, si dhe për të ushtruar një funksion mbikëqyrës për të treja ndërhyrjet në këtë masë prioritare.			
Objektivi 1.3 - Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe partneriteteve globale për migrim të sigurt dhe të rregullt. Fokusi në ripranimet.	Objektivi 1.3 - Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe partneriteteve globale për migrim të sigurt dhe të rregullt. Ndërhyrjet për realizimin e këtij objektivi, sidomos ndërhyrja 1.3.2 është e kufizuar, pasi ajo parashikon krijimin e partneriteteve të reja për migracionin e punës. Raporti i KE-së ka evidentuar se “projektmarrëveshjet e ripranimit janë dërguar nga autoritetet shqiptare në disa vende të origjinës, por deri më tani pa rezultat”. Tashmë prej vitesh është bërë problematike mungesa e një protokolli me Greqinë, e cila ka qënë në qendër të diskutimeve, mirëpo akoma nuk ka një rezultat konkret. Pas finalizimit dhe shtrirjes më të gjerë të këtyre marrëveshjeve, mund të flitet për partneritete	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)	I refuzuar	Lidhur me komentin, për ndjekjen e procesit të nënshkrimit për projektmarrëveshjet e ripranimit, sqarojmë se, është një fushë e lidhur me migracionin e parregullt dhe menaxhimin kufitar, e cila trajtohet gjerësisht në Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.

	në tregun e punës, pasi këto kërkojnë një angazhim dhe dakordësi më të gjerë dhe të konsoliduar midis shteteve. Në këtë kuadër, mbetet synim i mbartur që nga strategjia e kaluar edhe nevoja e bashkëpunimit më të shpejtë e efikas me ambasadat dhe shërbimet e kufirit e migracionit në vendet e origjinës për të identifikuar shtetasit e huaj e për të realizuar procedurat përkatëse të riatdhesimit të tyre.			
Masa prioritare 2.1.1 - Përmirësimi i kuadrit ligjor për migracionin e punës. Përfshirja në strategji e punës për negocimin me shtete të tjera përvec atyre të përfshira, për lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe ku ka emigrantë të shumtë nga Shqipëria.	Masa prioritare 2.1.1 - Përmirësimi i kuadrit ligjor për migracionin e punës. Kuadri ligjor për migracionin e punës është i mbështetur më së shumti mbi marrëveshjet dypalëshe. Aktualisht Shqipëria ka marrëveshje dypalëshe pune me Gjermaninë, Greqinë dhe Italinë. Mund të ishte parashikuar si ndërhyrje edhe lidhja e marrëveshjeve me vende të tjera, të cilat kanë një numër të madh emigrantësh shqiptarë. Për shkak të tendencave aktuale të	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)	I refuzuar	Lidhur me këtë koment, sqarojmë se draft-strategjia dhe plani i saj i veprimit synojnë përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor të migracionit të punës në përputhje me Acquis e BE, veçanërisht me kapitujt 2, 3, 19 dhe 24, të cilat kanë si detyrim edhe finalizimin e marrëveshjeve dypalëshe për njohjen e periudhave kontributive të

	vrullshme të emigracionit që kanë prekur Shqipërinë si vend origjine, do të duhet që institucionet përkatëse si fillim të evidentojnë se cilat janë vendet kryesore të destinacionit për emigrantët shqiptarë e më pas të punohet mbi lidhjen e marrëveshjeve me to. Si ndërhyrje akoma parashikohet që të përfundojë në vitin 2026 finalizimi i marrëveshjeve dypalëshe për njohjen e periudhave kontributive për sigurimet shoqërore me Italinë. Në fakt diskutimet për këtë marrëveshje kanë filluar që në vitin 2013, dhe sipas qeverisë, marrëveshja do të zbatohej që prej vitit 2023. Legjislacioni aktual është përqendruar kryesisht tek azili, azil-kërkuesit dhe refugjatët dhe më pak tek të drejtat e punëtorëve migrantë. Kjo gjetje, është aktuale edhe për situatën sot, megjithatë synohet që të ketë ndryshime përmes kësaj strategjie.			sigurimeve shoqërore.
--	--	--	--	-----------------------

Përfshirja e OSHC-ve në fushatat e ndërgjegjësimit.	- Masa prioritare 2.1.2 - Informimi mbi format, mundësitë dhe procedurat e migrimit për arsye pune në / nga RSH. KShH vlerëson se mund të përfshihen edhe ndërhyrje që krijojnë një bashkëpunim dhe gjithëpërfshirje aktive të OSHC-ve. OSHC-të kanë njohuri dhe qasje shumë të mirë dhe konkrete me persona të grupeve e komuniteteve të ndryshme, ndaj atyre mund t’ju jepet një rol i veçantë në fushata të informimit e ndërgjegjësimit. OSHC-të mund të përfshihen si subjekte që ofrojnë shërbimet e informimit dhe ato mund të angazhohen në krijimin e materialeve të përditësuara për shtetasit, me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme që shpjegon legjislacionin përkatës. Gjithashtu OSHC-të mund të	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)	I pranuar	Sugjerimi është reflektuar.
--	---	---	------------------	------------------------------------

	angazhohen në ofrimin e ndihmës juridike parësore lidhur me punësimin e emigrantëve.			
Parashikimi i objektivave konkretë dhe masave për përfshirjen e agjencive private të punësimit, si dhe rritja e bashkëpunimit të tyre me institucionet publike.	Masa prioritare 2.1.3 - Përmirësimi i veprimtarisë së agjencive private të punësimit. Në vitin 2018 u ndërmorën ndryshime ligjore lidhur me veprimtarinë e agjencive private të punësimit, në mënyrë që të caktoheshin standarde rekrutimi. Ndërkohë, kjo strategji që pritet të miratohet parashikon kryerjen e ndryshimeve të reja në aktet që rregullojnë funksionimin e agjencive private, të cilat pritet të realizohen brenda vitit 2026. Në vlerësimin e KShH-së mund të parashikohen ndërhyrje më konkrete dhe me synime më të qarta, pasi ndryshe procesi vetëm zvarritet. Monitorimi i punësimit të emigrantëve dhe standardet që parashikohen të vendosen në aktet përkatëse ligjore, duhet të kenë objektiva të qartë dhe të matshëm	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)	I pranuar	Komentet janë reflektuar. Draft-strategjia dhe plani i saj i veprimit parashikojnë hapa konkretë dhe të qartë, që deri në vitin 2026, të rishikohet legjislacioni që rregullon funksionimin e agjencive private të punësimit dhe të punësimit të përkohshëm, të identifikohet dhe publikohet lista e këtyre agjencive të liçensuara, si dhe të përditësohen broshurat dhe udhëzimet informuese për rekrutimin etik nga APP bazuar në legjislacionin e përmirësuar.

	brenda një kohe të shkurtër. Agjencitë private të punësimit duhet të luajnë një rol aktiv në proceset e monitorimit dhe rekrutimit të punëmarrësve, si dhe në informimin e tyre në të gjitha etapat përkatëse.			
Përfshirja e shtetasve shqiptarë rezident të përhershëm jashtë RSH, si dhe shtetasve shqiptarë me rezidencë të përkohsme, duke përfshirë në mënyrë konstruktive dhe diasporën shqiptare.	Masa prioritare 2.2.1 – Identifikimi dhe regjistrimi i adresave të shtetasve shqiptarë rezident të përhershëm jashtë RSH. Kjo masë duhet të parashikojë jo vetëm regjistrimin e rezidentëve të përhershëm me shtetësi shqiptare por edhe atyre me rezidencë të përkohshme. Ky proces do të kontribuojë edhe në jetësimin e një të drejtë politike të rëndësishme sikurse është e drejta për të zgjedhur, e cila si rezultat i vakumit ligjor të konstatuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të vitit që shkoi nuk është jetësuar ende (pavarësisht ndryshimeve që Kodi Zgjedhor pësoi në vitin 2020). Ndërhyrja	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)	I pranuar	Komenti është pranuar dhe reflektuar.

	në konfigurimin e platformës e-Albania për të lejuar aksesin në të dhe marrjen/ofrimin e shërbimeve vetëm në rastet kur vetëdeklarimi është i saktë duke i shtyrë shtetasit shqiptar të identifikohen dhe të deklarojnë vendbanimin e tyre. Çështja që shtrohet është se si do të zbatohet në praktikë dhe se si do të verifikohet saktësia e vetëdeklarimit të tyre. Rekomandohet përfshirja më e gjerë e përfaqësive konsullore dhe ambasadave, si dhe në bashkëpunim me shoqatat e emigrantëve/diasporës .			
Përmirsimi i infrastrukturës digjitale për informimin adekuat të qytetarëve.	Masa prioritare 2.2.3 – Informimi i emigrantëve mbi mundësitë e punësimit dhe tregut të punës në vend. Ndërhyrjet përputhen me objektivin specifik, janë realiste dhe të cilat mund të përmbushen gjatë periudhës së përcaktuar të Strategjisë. Në këto ndërhyrje, vetëm në dy nga to është vendosur	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)	I pranuar	Sugjerimi është reflektuar. Lidhur me këtë koment, donatorët dhe organizatat janë përfshirë si kontribuues për pasurimin e portalit të qeverisë shqiptare nga AKPA me informacion të qartë për procesin e kthimit dhe

	përfshirja e OSHC-ve, por në secilën nga ndërhyrjet OSHC-të që ofrojnë shërbime, mund të japin kontributin e tyre në bashkëpunim me institucionet përkatëse në ngritjen e platformave digjitale dhe online për emigrantët, të cilat lehtësojnë fushatat dhe komunikimet promovuese për mundësitë e tregut të shtetit shqiptar.			riintegrimin social ekonomik, por roli i këtyre aktorëve mbetet i hapur edhe për ndërhyrjet e tjera të kësaj mase.
Përfshirja aktive e OSHC-ve për masat 2.3.1 dhe 2.3.2.	Masat prioritare 2.3.1 dhe 2.3.2. OSHC-të që ofrojnë shërbime mund të përfshihen në vlerësimin e nevojave dhe sfidave që hasin emigrantët e rikthyer, hartimin e materialeve ndërgjegjësuese për ofrimin e shërbimeve për të kthyerit, ndjekjen dhe monitorimin e proceseve të lidhura me të kthyerit në tregun e punës, riintegrimin psiko-emocional dhe social si dhe në informimin e shtetasve shqiptar të ripranuar mbi shërbimet publike dhe jopublike që lehtësojnë riintegrimin e tyre në komunitet. I njëjti sugjerim për	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)	I pranuar	Komenti është reflektuar.

	përfshirjen e OSHC-ve vlen edhe në drejtim të masës 2.3.2, në prezantimin e programeve të trajnimit me në fokus migrantët aktual dhe potencial dhe përmirësimin e aftësive digjitale, si dhe përfshirjen e tyre digjitale për të lehtësuar të gjithë procesin e migrimit dhe integrimin të tyre.			
Aftësimi dhe trajnimi i mëtejshëm i stafit për migracioni për pritjen e të rinjve dhe kategorive vulnerabël.	Masa prioritare 3.2.2 - Plotësimi i nevojave specifike të fëmijëve, të rinjve, dhe kategorive vulnerabël. Në vitin 2022, 12,216 migrantë të parregullt hynë në Shqipëri, 235 prej tyre ishin fëmijë të pashoqëruar ose të ndarë. Vazhdon të jetë shqetësues numri i të miturve që udhëtojnë nga Shqipëria. Duhet të ndërmerren politika sociale për të parandaluar largimin e të miturve nga familjet dhe të zbatojnë plane specifike në shkolla dhe qendra sociale. Qendrat e pritjes	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)	I pranuar	Komenti është reflektuar.

	nuk menaxhojnë mirë situatat me grupet vulnerabël për shkak të mungesës së stafit të trajnuar dhe të mjaftueshëm, si dhe mungesës së ambienteve për këshillim psikologjik. OSHC-të mund të luajnë një rol më aktiv në monitorimin dhe menaxhimin e rasteve. Strategjia nuk ka parashikuar funksionimin e ambienteve të veçanta për të miturit e pashoqëruar në qendrat e pritjes, ndonëse BE e ka rekomanduar këtë. Duhet të parashikohen ndërhyrje konkrete për përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e kapaciteteve të qendrave ekzistuese. Bazuar në rekomandimet e KSHH-së, duhet të rritet buxheti për këto qendra dhe të krijohen ambiente për shërbime psikologjike dhe mjekësore.			
--	---	--	--	--

	Sugjerohet hartimi i një plani kombëtar për menaxhimin e situatave të flukseve migratore dhe rritja e buxhetit për qendrat dhe kapacitetet e stafit.			
--	--	--	--	--